




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>DPKI</u>	Prot. No. <u>06-375/20</u>
Nr. ffaq	Data
Broj stranica	Data <u>13.02.2020</u>
Nr. pages <u>02</u>	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.02.2020, mori:


V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI-06-2604/19*, për zyrtarin e lartë z. Adnan Zymeri, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Podujevës, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli *AKK-DPKI-06-2604/19*, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Adnan Zymeri, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Podujevës, është zhvilluar procedura e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia), sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e konflikt të interesit, sipas të cilit z. Adnan Zymeri, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, respektivisht Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Podujevës, i njëjti figuronte si Person i Autorizuar në biznesin privat “Adnan Zymeri” B.I. Me shkresën zyrtare *AKK-DPKI-06-01/19*, Agjencia fillimisht ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (në tekstin e mëtutjeshëm: ARBK), verifikimin dhe konfirmimin e informacionit lidhur me biznesin e cituar mësipër. Nga përgjigja e ARBK-së (shkresa zyrtare nr. *DPKI-06-02/2276-1/19*), rezulton se zyrtari i lartë z. Adnan Zymeri është pronar dhe person i autorizuar në biznesin në fjalë.



Me rastin e konfirmimit të informacionit të mësipërm, Agjencia në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Adnan Zymeri për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06-2604/19, dhe se në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese, ai ka të drejtë të njoftohet gjerësisht me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin në fjalë.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga zyrtari i lartë, është organizuar dhe mbajtur një takim brenda Agjencisë, ku i njëjti është njoftuar gjerësisht lidhur me faktin se, gjatë ushtrimit të funksionit në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, ai nuk mundet që njëkohësisht të jetë edhe Person i Autorizuar në biznesin privat, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, dhe si e tillë bie ndesh me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Adnan Zymeri është pajtuar tërësisht me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-366/20), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Adnan Zymeri ka bërë ndryshimet e kërkuara dhe i njëjti nuk figuron më të jetë Person i Autorizuar në biznesin privat “Adnan Zymeri” B.I.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Adnan Zymeri, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Podujevës, duke u tërhequr nga pozita e Personit të Autorizuar në biznesin në fjalë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë. Prandaj, në bazë të asaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

